



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 86

Tiranë – E premte, 21 prill 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 324, datë 12.4.2017	Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017..... 5091
Udhëzim i ministrit të Zhvillimit Urban nr. 2 datë 14.4.2017	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 1, datë 16.3.2017 “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore” 5101



VENDIM
Nr. 324, datë 12.4.2017

**PËR MIRATIMIN E REKOMANDIMEVE
PRIORITARE PËR PROKURORIN E
PËRGJITHSHËM, NË LUFTËN KUNDËR
KRIMINALITETIT, PËR VITIN 2017**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 103, të ligjit nr.97, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2017, sipas tekstit dhe relacionit që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohet ministri i Drejtësisë t'i përcjellë, menjëherë, Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare, si dhe t'ua bëjë ato të njohura drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve, në një mbledhje të përbashkët, jo më vonë se një muaj nga data e miratimit.

3. Ngarkohet ministri i Drejtësisë të ndjekë në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të këtyre rekomandimeve, sipas legjislacionit në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

**REKOMANDIME PRIORITARE
PËR PROKURORIN E PËRGJITHSHËM NË
LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT
PËR VITIN 2017
TIRANË, MARS 2017**

Në zbatim të nenit 103, të ligjit nr.97, datë 6.10.2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Këshilli i Ministrave miraton dhe i përcjell Prokurorit të Përgjithshëm rekomandimet prioritare që duhen ndjekur për vitin në vazhdim në luftën kundër kriminalitetit. Ministri i Drejtësisë ua bën të njohura rekomandimet e Këshillit të Ministrave drejtuesve të prokurorive të të gjitha shkallëve në një mbledhje të përbashkët. Këshilli i Ministrave,

nëpërmjet ministrit të Drejtësisë, ndjek në vazhdimësi mënyrën e zbatimit të rekomandimeve të dhëna prej tij.

Ky është kuadri ligjor që determinon përgatitjen e këtij dokumenti të rëndësishëm, që përmban rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave për organin e prokurorisë, detyrim ky që lidhet me përgjegjësinë shtetërore të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Drejtësisë, për ndjekjen dhe realizimin e politikës së përgjithshme shtetërore në fushën e drejtësisë.

Këto rekomandime kanë për qëllim dhe synojnë marrjen e masave për të garantuar funksionimin e sistemit të drejtësisë sipas parimeve të shtetit të së drejtës, marrjen e masave për parandalimin dhe luftën kundër kriminalitetit, në respektim të parimit themelor të kontrollit dhe ekuilibrit reciprok të pushteteve.

Përgatitja e këtyre rekomandimeve është mbështetur në analizën e dokumenteve strategjike qeveritare të tilla si Plani Kombëtar për Integrimin Evropian 2017 – 2020¹, Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020², Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2015-2020³; Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të organizuar, trafikeve të paligjshme dhe terrorizmit 2016 – 2020⁴, por dhe në raportet e organizmave ndërkombëtarë⁵, që lidhen me çështjet e krimit të organizuar, korrupsionit dhe trafikut të lëndëve narkotike.

Gjithashtu, në përgatitjen e këtyre rekomandimeve është shfrytëzuar kontributi i paraqitur nga strukturat e pushtetit ekzekutiv, të cilat kanë në përbërje të tyre personel që me ligj i është njohur cilësia e policisë gjyqësore⁶ dhe statistikave zyrtare për vitin 2016 të organit të prokurorisë.

Në 22 korrik 2016, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi ndryshimet kushtetuese, të cilat

¹ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM 42, date 25.1.2017 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.12/2017

² Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM 348, date 11.5.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.86.

³ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM 247, date 20.3.2015 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.47/2015.

⁴ Miratuar nga Këshilli i Ministrave, VKM 765, date 2.11.2016 dhe botuar ne Fletoren Zyrtare Nr.215/2016.

⁵ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel, më 09.11.2016 DPS (2016) dhe Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “International Narcotics Control Strategy Report- Money Laundering and Financial Crimes”, Mars 2017

⁶ Ministria e Puneve të Brendshme, Ministria e Mjedisit, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Financave nuk ka sjell kontribut



u shoqëruan në vijim edhe me miratimin e një sërë ligjesh të tjera të rëndësishme⁷ që reformojnë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të institucioneve të sistemit të drejtësisë, por edhe përcaktojnë rregulla të reja legjislacionit procedural penal. Synimi i kësaj refome të rëndësishme është rritja e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, veçanërisht nga ndikimi politik, dhe çlirimi i tij nga korrupsioni e paaftësia.

Sipas këtij kuadri ligjor, tashmë të miratuar dhe hyrë në fuqi, por edhe në ligjet e sapo miratuara në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë⁸, Prokuroria do të funksionojë si një organ i decentralizuar duke garantuar mbarëvajtjen e veprimtarisë së saj, nëpërmjet respektimit të pavarësisë së brendshme të prokurorëve në ushtrimin e ndjekjes penale, në përfaqësimin e akuzës në gjyq dhe në plotësimin e funksioneve të tjera të dhëna me ligj.

Në vizionin e qeverisë shqiptare në përputhje me programin e saj qeverisë, Shqipëria duhet të jetë:

i) një vend i bazuar në shtetin e së drejtës, garant për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, me një sistem të hapur dhe të barabartë gjyqësor që siguron drejtësi për të gjithë;

ii) një vend me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë; dhe

iii) një shoqëri që respekton dhe mbron të drejtat e njeriut, garanton parimin e barazisë dhe promovon mundësi dhe shance të barabarta si një mjet efikas për një demokraci të konsoliduar dhe shtet ligjor.

Në funksion të realizimit të këtij vizioni, qeveria do të jetë e palëkundur në objektivat e saj duke mbështetur dhe kërkuar angazhimin maksimal të institucioneve ligjzbatuese, në marrjen e masave për reformimin e sistemit të drejtësisë, luftën kundër korrupsionit, goditjen e krimit të organizuar në të gjitha format e tij, intesifikimin e luftës kundër terrorizmit dhe krimit ndërkombëtar, në respekt të plotë të lirive dhe të drejtave të individit, barazisë e shtetasve përpara ligjit, dhe angazhimeve të saj ndërkombëtare.

Për vitin 2017, rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave që duhen ndjekur për vitin në vazhdim nga organi i prokurorisë në luftën kundër kriminalitetit do të jenë në drejtimet e mëposhtme:

Garantimi i pavarësisë të prokurorit

Garantimi i pavarësisë së prokurorit lidhet ngushtësisht me reformën e ndërmarrë në sistemin e drejtësisë në Shqipëri. Një reformë tërësore dhe gjithëpërfshirëse për të forcuar pavarësinë, llogaridhënien, eficientën dhe profesionalizmin e gjyqësorit është një hap i rëndësishëm për të caktuar një pikë kthese pozitive mbi konsolidimin e sundimit të ligjit në vend, me një impakt afatgjatë domethënës në të ardhmen.

Në lidhje me problemin e korrupsionit brenda sistemit gjyqësor, reforma në drejtësi do të krijojë kushtet që trupa e gjyqtarëve dhe prokurorëve të përmbushë standardet më të larta të integritetit dhe të etikës. Sistemet për matjen e performancës profesionale të gjyqtarëve dhe të prokurorëve do të perfeksionohen dhe rezultatet e tyre do të shndërrohen në kritere ekskluzive për ecurinë e magistratëve në karrierë.

Qeveria shqiptare e pranon se është me rëndësi kritike pasja e një rrjeti profesionistësh gjyqësor-prokurorë që kanë aftësitë, njohuritë dhe sjelljen e duhur që do t'i pajisë ata për të përmbushur kërkesat e një sistemi modern gjyqësor. Procesi ka nisur por ka ende shumë punë për të bërë në këtë fushë. Për këtë qëllim theks i veçantë i vihet ndryshimeve të organizimit, rekrutimit, disiplinës dhe aftësive/zhvillimit të vazhdueshëm të këtyre profesionistëve. Drejtësia duhet të administrohet dhe të kontrollohet nga profesionistë shumë të aftë, në atë mënyrë që të duket se është e lirë nga ndikimi i panevojshëm politik dhe ndërhyrje të tjera të panevojshme të fshehta.

Nga monitorimet që organizmat ndërkombëtare i kanë bërë gjendjes në Shqipëri⁹ lidhur me funksionimin e sistemit gjyqësor, midis të tjerave evidentohet se, *...Ekszistojnë raporte të vazhdueshme për ndërhyrjen politike në çështjet e hetimit dhe të gjykatave.... Sistemi shërbimit të prokurorisë për menaxhimin e rasteve nuk është ende plotësisht funksional në mbarë vendin, përveçse për qëllimin e regjistrimit rasteve.... Nuk ka monitorim të mjaftueshëm për respektimin e*

⁷ Ligje të miratuara në Kuvendin e Shqipërisë në datat 30 Gusht 2016; 6 Tetor 2016; 3 Nëntor 2016 dhe 30 Mars 2017.

⁸ Ligji për ndryshime në K.Pr.Penale, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 30 Mars 2017.

⁹ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel, më 09.11.2016 DPS (2016),



standardeve etike dhe integritetit të gjykatësve dhe prokurorëve... Kobëzgjatja e përgjithshme e procedimeve është shkaktuar shqetësimi dhe lidhet kryesisht me mungesën e kapacitetit dhe papërshtatshmërisë së dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave... Për më tepër, u miratua një paketë ligjesh të tjera organike, të identifikuara si prioritare për implementimin e reformës në drejtësi, të cilat rregullojnë organizimin e gjyqësorit, prokurorisë, statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe krijimin e strukturave të reja kushtetuese për luftën kundër korrupsionit... Me qëllim përmbushjen e prioritetit kyç të reformës në sistemin e drejtësisë, gjatë vitit të ardhshëm, duhet të avancohet për implementimin e dispozitave të reja kushtetuese dhe legjislacionit të ri të lidhur me to...”.

Sipas perceptimit të publikut, sistemi gjyqësor vazhdon të perceptohet si shumë i korruptuar, influenca politike në sistemin gjyqësor është një tjetër problem shqetësues.

Po ashtu, mungesa e rolit aktiv të prokurorit në ndjekjen penale, vazhdon të jetë evidente. Nga të dhënat statistikore rezulton se: Në vitin 2016, **numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe të kallëzuar është 42 396, nga të cilat vetëm 231 janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose 0,54% e numrit të përgjithshëm.**

Ndryshimet kushtetuese dhe ligjet organike dhe procedurale të miratuara në vijim kanë rishikuar mënyrën e organizimit të brendshëm të sistemit të prokurorisë, me qëllim garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimarrjen për çështje konkrete, duke ruajtur njëkohësisht qëndrueshmërinë e organit të prokurorisë dhe uniformitetin e veprimtarisë së saj.

Kështu në nenin 148 të Kushtetutës¹⁰ është parashikuar se, *Prokuroria është organ i pavarur që garanton mbarëvajtjen, kontrollin e veprimeve të saj dhe respekton pavarësinë e brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, sipas ligjit.*

Ligji nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”¹¹, në nenin 6, të tij përcakton se: *Në ushtrimin e funksioneve të tyre, prokurorët kryejnë veprime, parashitrojnë kërkesa dhe marrin vendime në mënyrë të pavarur, bazuar në parimet e ligjshmërisë, objektivitetit dhe*

paanshmërisë. Prokurorët u nënshtrohen udhëzimeve të përgjithshme me shkrim të prokurorit më të lartë, sipas dispozitave të këtij ligji. Ligji garanton pavarësinë dhe autonominë e nevojshme për marrjen e vendimeve gjatë ushtrimit nga prokurorët të funksionit të tyre kushtetues e ligjor, pavarësisht ndikimit të paligjshëm të brendshëm apo të jashtëm nga çdo autoritet publik a privat.

I njëjti parashikim ligjor është parashikuar edhe në ndryshimet e propozuara për Kodin e Procedurës Penale, miratuar së fundmi në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë¹² ku nenet 24 dhe 25 janë ndryshuar në funksion të sanksionimit të kësaj pavarësie. Pra, prokurori është përgjegjës për çështjen që i ngarkohet dhe i pavarur në punën e tij, me detyrimin në çdo rast të ndjekë udhëzimet e natyrës së përgjithshme të prokurorëve më të lartë, me qëllim unifikimin e qëndrimit të prokurorisë për problematika të caktuara, bazuar edhe në rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit.

Neni 149 i Kushtetutës, përcakton se Këshilli i Lartë i Prokurorisë është autoriteti që garanton pavarësinë, llogaridhënien, disiplinën, statusin dhe karrierën e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë. Në të njëjtën linjë me përcaktimin kushtetues janë edhe parashikimet ligjore në ligjet nr.97/2016 dhe nr.115/2016, të cilat parashikojnë një rol të rëndësishëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në përzgjedhjen dhe propozimin e kandidaturave për Prokuror të Përgjithshëm dhe në garantimin e rregullshmërisë së procesit të përzgjedhjes së tij, si dhe për aspekte të caktuara të funksionimit të prokurorisë, bëhen referenca në rregullimet e posaçme ligjore.

Ligji nr.97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, përcakton rregulla të detajuara për të siguruar që shpërndarja e çështjeve prokurorëve të kryhet në mënyrë që të përmbushë kërkesat për paanshmëri dhe objektivitet, duke marrë njëkohësisht në konsideratë edhe nevojën për rritjen e efikasitetit të veprimtarisë së saj. Sipas këtij ligji neni 53 i tij, Prokurori i Përgjithshëm ka detyrimin të miratojë rregulla të hollësishtme në lidhje me procedurat e ndarjes së çështjeve me short.

¹⁰ Ligji 76/2016 miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë datë 22.7.2016, botuar në fletoren Zyrtare nr.138/2016

¹¹ Miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë datë 6.10.2017, botuar në fletoren Zyrtare nr.209/2016

¹² Ligji për ndryshime në K.Pr.Penale, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën plenare të datës 30 Mars 2017.



Bazuar në konstatimet e sipërcituara dhe parashikimet e reja ligjore, me qëllim forcimin dhe garantimin e pavarësisë së brendshme të prokurorëve për hetimin dhe ndjekjen penale, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Marrjen e masave për zbatimin e legjislacionit të ndryshuar, lidhur me mënyrën e organizimit të brendshëm të sistemit të prokurorisë, në funksion të rritjes së pavarësisë efikasitetit, integritetit dhe llogaridhënien e prokurorit;

ii) Marrjen e masave për përcaktimin e rregullave të detajuara, lidhur me shpërndarjen e çështjeve, në funksion të rritjes së paanshmërisë, pavarësisë dhe efikasitetit të punës së prokurorisë;

iii) Marrjen e masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, dhe kryerjes së hetimeve të shpejta me qëllim shkurtimin e kohëzgjatjes së hetimeve dhe periudhës së paraburgimit;

iv) Marrjen e masave për respektimin e standardeve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve;

v) Marrjen e masave për rritjen profesionale të prokurorëve sidomos në funksion të njohjes dhe zbatimit të paketës së re ligjore të reformës në drejtësi ligjeve organike dhe atij procedural penal.

Lufta kundër korrupsionit

Qeveria shqiptare angazhohet për luftë pa kompromis dhe zero tolerancë kundër korrupsionit. Institucionet ligjzbatuese kanë një rol thelbësor për sa i përket ndëshkimit të korrupsionit, ato duhet të monitorojnë zbatimin e ligjit dhe sundimin e shtetit të së drejtës duke siguruar kështu transparencën dhe integritetin e organeve shtetërore. Korrupsioni është pengesa kryesore në rrugën e zhvillimit të qëndrueshëm politik, ekonomik dhe shoqëror të shteteve. Parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është edhe një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtare për luftën kundër korrupsionit, si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit. Në përgjigje të nevojave të vendit për zhvillim dhe pritshmëri të ligjshme të publikut dhe partnerëve tanë ndërkombëtarë,

Nga monitorimet që organizmat ndër-

kombëtarë i kanë bërë gjendjes në Shqipëri¹³ lidhur me luftën kundër korrupsionit evidentohet se: ...*“Krabas progresit të arritur me krijimin e një strukture antikorrupsion dhe përpjekjes për krijimin e një track rekordi të hetimeve dhe dënimeve për çështjet penale të korrupsionit, sërish korrupsioni mbetet problem shqetësues... Numri i dënimeve të formës së prerë që përfshijnë zyrtarë nivelit të ulët ose të mesëm është në rritje prej vitit 2010, por në përgjithësi mbetet i ulët. Bashkëpunimi i dobët ndërinstitucional dhe mungesa e një shkëmbimi informacioni efektiv ka ndikuar negativisht në zhvillimin e hetimeve proaktive dhe dënimit. Hetimet financiare nuk kryhen sistematikisht dhe numri i rasteve të konfiskimit të pasurisë në rastet e korrupsionit është i ulët. Kjo pasi numri i asetëve të konfiskuara gjatë fazës fillestare është i ulët, duke sjellë për pasojë një numër të ulët asetesh të konfiskuara në kohën e dënimit përfundimtar. ...Gjithashtu, probleme paraqiten me ruajtjen e sekretit hetimor dhe publikimet e shfaqura në media.... Numri dhe frekuenca e kontroleve mbi deklaratat e pasurisë është rritur në vitin 2014. Megjithatë, shumë referime nuk po ndiqen penalisht... Hetimet aktive, bazuar në analizat e rrezikut duhet të rriten ndjeshëm për të zhvilluar rezultate bindëse me hetime, ndjekje penale dhe dënime në çështjet e korrupsionit.*

Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit i marsit 2017 përmend se¹⁴ *“...Vendi paraqet rrezik për pastrimin e produkteve të veprës penale për shkak të nivelit të lartë të korrupsionit... Janë ndërmarrë masa për hetimin e korrupsionit në nivel zyrtarësh të lartë, por ka një numër të vogël hetimesh për korrupsionin në radhët e prokurorëve dhe gjyqtarëve... Pavarësisht numrit të çështjeve për pastrimin e produkteve të veprave penale për të cilat ka nisur hetimi, numri i çështjeve të përfunduara në gjykim dhe numri i dënimeve për këto vepra mbetet i ulët.”*

Nga të dhënat statistikore rezulton se nga organi i prokurorisë për vitin 2016¹⁵ janë regjistruar 1 526 çështje penale për veprat penale në fushën e korrupsionit dhe janë marrë të pandehur 386 persona. Krahasuar me numrin e çështjeve të vitit të kaluar¹⁶ vihet re një rritje e vogël e numrit të çështjeve, me 34 çështje, por një ulje e numrit të personave të pandehur (55 persona më pak).

¹³ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel 09.11.2016

¹⁴ Raporti i Departamentit Amerikan të Shtetit “International Narcotics Control Strategy Report- Money Laundering and Financial Crimes”, Mars 2017.

¹⁵ Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga organi i prokurorisë për vitin 2016.

¹⁶ Në 2015 ishin 1492 çështje në hetim me 398 persona nën hetim dhe 441 të pandehur.



Ndërkohë, rezulton se janë dërguar për gjykim vetëm 212 procedime penale ose rreth 13,9 % të rasteve, me 371 të pandehur, numër më i ulët se për vitin 2015¹⁷. Për vitin 2016, ka përfunduar gjykimi për 192 çështje penale (për veprat penale kundër korrupsionit) me një numër prej 312 të pandehurish.

Të dhënat statistikore të vitit 2016, për veprat penale në fushën e korrupsionit, tregojnë se ndonëse ka rritje të numrit të çështjeve të regjistruara, vihet re një ulje e numrit të çështjeve të dërguara për gjykim, dhe numrin e çështjeve të përfunduara në krahasim me vitin 2015¹⁸.

Në vitin 2016, numri i përgjithshëm i veprave penale të referuara dhe kallëzuar është 42 396, nga të cilat vetëm 231 janë vepra penale të filluara kryesisht nga prokurori, ose 0,54% e numrit të përgjithshëm. Nga 231 çështje penale të filluara kryesisht nga prokurori, vetëm 60 janë të filluara kryesisht për veprat penale në fushën e korrupsionit, ose rreth 26 % e numrit të çështjeve.

Nga numri i procedimeve të filluara, kryesisht pjesa më e madhe e tyre - 37 çështje, janë filluar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal. E krahasuar me numrin e çështjeve të filluara kryesisht në fushën e korrupsionit të një viti më parë (24 çështje të filluara kryesisht), vihet re një rritje e numrit të çështjeve mbi dy herë, megjithatë numri i çështjeve të filluara mbetet përsëri i ulët.

Në ndryshim nga viti i kaluar, nga të dhënat statistikore rezultojnë 2 çështje të filluara kryesisht për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, neni 287/1 i Kodit Penal dhe vetëm 1 çështje e filluar kryesisht për veprën penale “Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtaria kriminale”, neni 287/b i Kodit Penal.

Ndryshimet e reja ligjore në kuadër të reformës në drejtësi janë premisa dhe garanci më tepër në luftën kundër korrupsionit, në funksion të rritjes së hetimeve proaktive dhe përdorimit të metodave speciale të hetimit, rritjes së kapaciteteve dhe bashkëpunimit për hetimin e korrupsionit, si dhe marrjen e masave për hetimet më efikase dhe

efektive të kësaj kategorie veprash penale. Hetimi penal i krimit të korrupsionit duhet të jetë i shpejtë, pasi provat që vërtetojnë kryerjen e këtyre krimeve janë veçanërisht të prirura për tu zhdukur. Korrupsioni i zyrtarëve të lartë publikë duhet të dënohet sipas parashikimeve ligjore, duke evidentuar qartazi që ndëshkimi i ligjit aplikohet në mënyrë të barabartë për të gjithë.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara dhe parashikimet e reja ligjore, me qëllim forcimin e luftës kundër korrupsionit, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Forcimin e bashkëpunimit me institucionet e tjera ligjzbatuese në ndjekjen penale dhe ndërkimimin penal të korrupsionit, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin e veprimeve hetimore në kohë reale dhe me efikasitet;

ii) Forcimin e rolit aktiv të prokurorit sidomos në drejtim të rritjes së numrit të hetimeve proaktive;

iii) Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve, sidomos të rasteve të zyrtarëve të lartë publikë, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe duke kryer hetime të plota financiare brenda dhe jashtë vendit;

iv) Hetime sistematike pasurore dhe rritje të numrit të aseteve të konfiskuara në rastet e korrupsionit sidomos në fazën fillestare të hetimeve;

v) Rritje e numrit të çështjeve të regjistruara, atyre të dërguara për gjykim dhe përfunduar me vendim dënimi të formës së prerë, për rastet e kallëzuar në prokurori nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurisë dhe Konfliktit të Interesit dhe nga Kontrolli i Lartë i Shtetit;

vi) Ashpërsim të politikës penale në drejtim të masave të sigurimit dhe atyre të dënimit për të gjitha rastet e evidentuara të korrupsionit;

vii) Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin e veprave penale të korrupsionit, me qëllim evidentimin e saktë dhe dokumentimin ligjor të hetimeve;

viii) Trajnimi i mëtejshëm i strukturave përkatëse për hetimin e çështjeve komplekse të korrupsionit sidomos me ndryshimet e reja ligjore dhe shkencore;

ix) Rritja e aksesit në bazat e të dhënave kombëtare me qëllim shmangien e procedurave të

¹⁷ Në vitin 2015 numri i çështjeve të dërguara për gjykim për këto vepra ka qënë 245 procedime (16,5 % e rasteve) me 436 të pandehur.

¹⁸ Në vitin 2015 kishin përfunduar gjykimin 214 çështje penale me 373 të pandehur.



gjata burokratike për marrjen e informacioneve;

x) Mbajtjen dhe evidentimin e të dhënave statistikore të sakta dhe të koordinuara me institucionet e tjera ligjzbatuese, me qëllim analizimin e treguesve, në funksion të marrjes së masave dhe politikave përkatëse, për të bërë sa më efektive luftën kundër korrupsionit. Për këtë është e nevojshme rritja e numrit dhe cilësisë së burimeve njerëzore dhe ndërlidhjes së sistemeve elektronike.

Lufta kundër krimit të organizuar

Shqipëria me një shoqëri pa trafikim, krim të organizuar dhe kërcënime terrorizmi, dhe me një imazh të një vendi paqësor dhe me standarde evropiane të sigurisë, është vizioni që qeveria shqiptare kërkon të arrijë në kuadër të zhvillimit dhe integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Shqipëria është e angazhuar për të çuar përpara rezultatet pozitive të arritura dhe për të adresuar rekomandimet e raportit të progresit të Komisionit Evropian të vitit 2015. Për vitin 2017 objektiv parësor i qeverisë mbetet thellimi i mëtejshëm i luftës kundër krimit të organizuar.

Në kuadër të përmbushjes së objektivave dhe detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare synon të forcojë koordinimin ndër-institucional në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizmit, trafikimit në të gjitha format e tij dhe parandalimin e goditjen e pastrimit të parave. Një tjetër synim është dobësimi i financave të rrjeteve kriminale të krimit të organizuar dhe terrorizmit nëpërmjet shënjestrimit, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurive dhe të ardhurave të përfituara nga aktiviteti kriminal.

Monitorimet ndërkombëtare sa i përket luftës kundër krimit të organizuar, përfshirë pastrimin e parave, trafikimin e qenieve njerëzore dhe drogës¹⁹ theksojnë se, ... *policia dhe prokuroria kanë dështuar në zbulimin e grupeve të organizuara që fshihen pas kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike. Është e nevojshme të forcohet bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë me qëllim zbulimin efektiv të rrjeteve kriminale. Numri i të dënuarve për çështje të krimit të organizuar mbetet i ulët, Hetimet financiare për personat e dyshuar si pjesëtarë të grupeve kriminale nuk janë sistematike dhe efektive. Një përqindje e lartë e çështjeve të krimit të organizuar transferohen në prokuroritë e rretheve ose pushohen për shkak të mungesës së provave ose cilësisë së referimit të veprave. Është i nevojshëm*

përmirësimi i cilësisë së referimit, mbledhjes së provave si dhe cilësia e vendimeve të pushimit... Duhet të shtohen përpjekjet për hetimin e çështjeve të trafikimit, veçanërisht të të miturve të cilët janë në rrugë. Numri i të dënuarve për këto vepra mbetet i ulët. ...Pavarësisht intensifikimit të luftës kundër kultivimit dhe trafikimit të lëndëve narkotike, kryesisht cannabis sativa, numri i dënimeve përfundimare mbetet i ulët. Dënimet nuk janë mjaftueshëm të ashpër për të ndaluar dhe konfiskimi i aseteve kriminale është i kufizuar. Hetimet dhe dënimet nuk kanë depërtuar në nivelet e larta të strukturës kriminale dhe nuk shoqërohen në mënyrë sistematike me hetime financiare.... Ka një trend në rritje për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale, megjithatë numri i dënimeve mbetet i ulët... ..Shqipëria është prekur nga fenomeni i terrorizmit. Ky fenomen ka nevojë për një përjasje të përbashkët nga shërbimet e inteligjencës autoritet ligjzbatuese dhe institucionet e drejtësisë, duke u fokusuar dhe në mekanizmat parandalues, të cilat përfshijnë shoqërinë civile dhe komunitetet fetare...”

Lidhur me veprat penale të krimit të organizuar, nga track record²⁰ rezulton se për vitin 2016 janë regjistruar 44 procedime penale të reja, nga të cilat, të filluara kryesisht janë 7 procedime, ose 3 % e numrit të përgjithshëm të çështjeve të filluara kryesisht për këtë vit (231 çështje). Nga 44 procedime të regjistruara janë dërguar për gjykim 3 prej tyre. Ndërkohë rezulton se në këtë vit janë dërguar për gjykim dhe 4 procedime të filluara përpara vitit 2016, por hetimet paraprake për këto procedime kanë përfunduar në vitin 2016.

Nga të dhënat statistikore rezulton se nga organi i prokurorisë për vitin 2016²¹ janë regjistruar 4 081 çështje penale për veprat penale në fushën e lëndëve narkotike, me një numër total prej 1 525 personash nën hetim. Gjatë hetimeve janë marrë të pandehur 1 262 persona. Nga numri total i çështjeve të regjistruara për këtë kategori veprash penale, vetëm 735 çështje ose 18% e çështjeve janë dërguar për gjykim me një numër prej 1 057 personash të dënuar. Pra, numri i çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim me numrin e përgjithshëm të çështjeve të regjistruara për këtë kategori veprash penale është i ulët, fakt ky që ndikon në efektivitetin e ndjekjes penale ndaj këtij fenomeni.

²⁰ Raportimi për gjurmimin e veprave penale të krimit të organizuar.

²¹ Sipas të dhënave statistikore të përcjella nga organi i prokurorisë për vitin 2016.

¹⁹ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel 09.11.2016



Prioriteti kryesor, për vitin 2017, duhet të jetë rritja e numrit të hetimeve proaktive dhe hetimeve financiare për pastrimin e parave dhe trafikimin e drogës; si dhe rritja e konfiskimit të pasurisë së fituar në rrugë kriminale. Nga monitorimet e organizmave ndërkombëtare rezulton se një tjetër prioritet duhet të jetë progresi i mëtejshëm në ngritjen e një historiku solid të investigimeve, ndjekjeve dhe dënimeve në luftën kundër krimit të organizuar.

Paketa ligjore e reformës në drejtësi që shoqëron ndryshimet kushtetuese²² do të plotësojë edhe më tej kuadrin ligjor të brendshëm. Zbatimi i kuadrin ligjor dhe forcimi i bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese ndërkombëtare, luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin dhe forcimin e luftës kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara dhe parashikimet e reja ligjore, me qëllim forcimin e luftës kundër krimit të organizuar, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Forcim të bashkëpunimit ndërmjet prokurorisë dhe policisë, si dhe me institucionet e tjera ligjzbatuese brenda dhe jashtë vendit, në funksion të koordinimit më tej të hetimeve për të mbledhur në rrugë ligjore provat e mjaftueshme, për të patur rritje të numrit të hetimeve të suksesshme dhe numrit të vendimeve të dënimit të formës së prerë;

ii) Hetime sistematike pasurore dhe rritje të numrit të asetëve të konfiskuara në rastet e grupeve kriminale sidomos në fazën fillestare të hetimeve;

iii) Rritje të numrit dhe të cilësisë së hetimeve sidomos të rasteve të organizatave dhe grupeve të strukturuar kriminale, duke përdorur metoda speciale të hetimit dhe kryer hetime të plota financiare brenda dhe jashtë vendit, në funksion të shkatërrimit të rrjeteve kriminale të përfshira në të gjitha format e krimit të organizuar;

iv) Rritje të hetimeve komplekse, metodave speciale të hetimit, ngritjes së grupeve të përbashkëta hetimore me agjencitë e tjera ligjzbatuese, bashkëpunimit me institucionet

financiare për rastet e kultivimit dhe trafikimit të drogës, me qëllim identifikimin dhe ndjekjen penale të grupeve të strukturuar kriminale (financuesve, organizatorëve, trafikantëve, ndërlidhësve, kultivues dhe shpërndarës), që fshihen pas tyre;

v) Ashpërsim të politikës penale në drejtëm të masave të sigurimit dhe dënimit për të gjitha rastet e organizatave kriminale dhe grupeve të strukturuar kriminale, kultivuesve dhe trafikuesve të kanabis²³;

vi) Rritje të numrit të çështjeve penale por sidomos të dënimeve të formës së prerë për çështjet e pastrimit të produkteve të veprës penale. Për këtë të fundit është e nevojshme kryerja e veprimeve proaktive dhe metodave të posaçme të hetimit, koordinimi me agjencitë ligjzbatuese dhe institucionet financiare dhe të pasurive të paluajtshme;

vii) Trajnim të burimeve njerëzore në prokurori në drejtëm të teknikave speciale dhe hetimeve komplekse, krimeve financiare, krimeve kibernetike dhe ndryshimet e reja ligjore;

viii) Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore të ngarkuar me hetimin e veprave penale të korrupsionit, me qëllim evidentimin e saktë dhe dokumentimin ligjor të hetimeve;

ix) Rritjen e aksesit në bazat e të dhënave kombëtare me qëllim kryerjen në kohë reale të veprimeve hetimore, në funksion të rritjes së efektivitetit të hetimeve;

x) Rritjen e bashkëpunimit me agjencitë ligjzbatuese rajonale dhe ndërkombëtare për parandalimin e krimeve kompjuterike, të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për financimin e terrorizmit;

xi) Mbatjen dhe evidentimin e të dhënave statistikore të sakta dhe të koordinuara midis agjencive ligjzbatuese, me qëllim analizimin e treguesve, në funksion të marrjes së masave dhe politikave përkatëse, për të bërë sa më efektive luftën kundër krimit të organizuar. Për këtë është e nevojshme rritja e numrit dhe cilësisë së burimeve njerëzore dhe ndërlidhjes së sistemeve elektronike.

²² Janë në proces konsultimi dhe miratimi në Kuvendin e Shqipërisë ndryshimet ligjore të ligjeve: nr.157/2013 *Për Masat kundër Financimit të Terrorizmit*; nr.9917/2008 *Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit* dhe nr.192/2009 *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë etj.*

²³ në kuadër të plan veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të cannabis



Të drejtat e njeriut

Qeveria shqiptare është e angazhuar për përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe pakicave. Shqipëria është palë në një sërë konventash për të drejtat e njeriut në kuadrin e OKB-së, Këshillit të Evropës, si dhe palë në Konventën Kuadër të Këshillit të Evropës “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”. Një ndër prioritetet kyçe të qeverisë mbetet respektimi dhe mbrojtja e të drejtave të individëve të grupeve vulnerable, dhe në mënyrë të veçantë e të miturve, në konflikt me ligjin, pasi respektimi i të drejtave themelore të njeriut në ligj dhe në praktikë është i një rëndësie madhore po aq sa edhe lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Monitorimet ndërkombëtare për sa i përket të drejtave të njeriut²⁴, theksojnë se, *...mekanizmat mbrojtës të të drejtave të të miturve dhe adresimit të dhunës në familje dhe dhunës me mbazë gjinore vazhdojnë të jenë të dobët. Legjislacioni për të miturit ka nevojë për tu përshtatur me standardet ndërkombëtare. Është e nevojshme të përmirësohet shërbimi për viktimat në cilësi, sasi dhe shtrirje territoriale. Mungojnë të dhënat për çështjet me natyrë diskriminuese... Pavarësisht progresit të politikave të barazisë gjinore, dhuna në familje mbetet problem serioz. Numri i rasteve ku viktimat është femër është shprehja e qartë e dhunës në familje me natyrë gjinore.*

Me vendimin nr.733 datë 20.10.2016, të Këshillit të Ministrave, është miratuar Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore (SKBGJ) 2016-2020 dhe plani i saj i veprimit. Objektivi kryesor i kësaj strategjie, krahas prioriteteve dhe drejtimeve kryesore për zhvillim, është dhe arritja e barazisë gjinore dhe luftën kundër dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje.

Nga të dhënat statistikore të organit të prokurorisë konstatohet një numër i madh çështjesh penale në hetim për veprën penale të “Dhuna në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Janë 1 614 çështje me 421 persona nën hetim dhe 1 271 persona në cilësinë e të pandehurit gjatë hetimeve. Nga ky numër rezulton se 1 157 çështje janë dërguar për gjykim ose 71,7 % e çështjeve, me një numër prej 1238 të pandehurish- 97,4% e të pandehurve të dënuar.

Prioritet i qeverisë shqiptare është dhe domosdoshmëria për të siguruar mbrojtjen e

fëmijëve nëpërmjet mekanizmave ligjore dhe institucionale dhe angazhimitt ë përbashkët për garantimin e drejtësisë miqësore dhe realizimin e interesave më të lartë të fëmijës. Pjesë e rëndësishme e reformës në drejtësi është dhe vendosja e standarteve për respektimin e të drejtave të të miturve, jo vetëm si autorë të veprave penale, por dhe në pozicione të tjera procedurale në kontakt me sistemin e drejtësisë. Legjislacioni për të miturit i miratuar së fundmi në Kuvendin e Shqipërisë²⁵, synon të korrigjojë mospërputhjen midis legjislacionit ndërkombëtar për të miturit, të ratifikuar nga vendi ynë dhe zbatimit në praktikë nga autoritetet ligjzbatuese.

Drejtësia e vonuar është drejtësi e mohuar, prandaj për të patur sukses në luftën kundër kriminalitetit është e nevojshme të kryhen hetime të shpejta dhe efikase. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjykimi i drejtëpërdrejtë vijon të jetë një nga llojet e gjykimeve më pak të kërkuara nga organi i prokurorisë.

Organi i prokurorisë për vitin 2016 ka dërguar për gjykim 12 997 çështje, por vetëm për 1 241 prej tyre ka kërkuar që të gjykohen me procedurë gjykimi të drejtëpërdrejtë. Rezultoni se ky numër ka pësuar rritje krahasuar me vitin e kaluar, por sërish vijon të mbetet i ulët në raport me numrin e përgjithshëm të çështjeve- 9,5 % të tyre.

Në ndryshimet e fundit të sapomiratuara që i janë bërë ligjeve që lidhen me drejtësinë penale janë parashikuar koncepte të reja dhe norma ligjore në drejtim të garantimit të të drejtave të gjithë subjekteve të procedimit penal, të cilat janë një garanci më tepër për respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut përgjatë procesit penal. Këto norma është e nevojshme të njihen dhe të zbatohen nga oficerët e policisë gjyqësore dhe prokurorët, për këtë është e nevojshme rritja e profesionalizmit dhe përmbushja e detyrimeve ligjore prej tyre.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara dhe parashikimet e reja ligjore, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut të subjekteve të procedimit penal, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

²⁴ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel 09.11.2016
Faqe | 5098

²⁵ Kodi i Drejtësisë për të Mitur, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në seancën e datës 30.03.2017



i) Rritje të numrit të çështjeve penale të hetuara dhe dënuar me vendim të formës së prerë për rastet e nxjerrjes së fëmijëve për të lypur ose punuar në rrugë/shfrytëzimit të fëmijëve;

ii) Kërkesa për masën e sigurimit “arrest në burg” për të miturit, të jetë rast përjashtimor, dhe në rastet kur ajo kërkohet/vendoset, duhet që hetimet të përfundojnë në kohën më shkurtër të mundshme;

iii) Hetime të shpejta, efektive dhe ashpërsim të politikës penale, në rastet e veprave penale me natyrë gjinore dhe diskriminuese, duke patur në vëmendje të veçantë rastet e dhunës në familje;

iv) Fuqizimi i kapaciteteve profesionale të oficerëve të policisë gjyqësore dhe prokurorëve të ngarkuar me hetimin e veprave penale me subjekt të procedimit penal të miturit, viktimat e dhunës në familje dhe atyre të trafikimit;

v) Rritje të kërkesave për gjykim të drejtëpërdrejtë në funksion të një hetimi të shpejtë dhe efikas, sidomos për rastet me të paraburgosur;

vi) Hetime të shpejta, efektive, dhe ashpërsim të politikës penale për veprat penale që prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve;

vii) Hetime të shpejta dhe ashpërsim të masës së dënimit për veprat penale kundër mjedisit;

viii) Zbatimin e të drejtës së informimit për subjektet e procedimit penal sidomos për rastet e viktimit të veprës penale²⁶.

Bashkëpunimi ndërinstytucional

Në kuadër të përmbushjes së objektivave dhe detyrimeve ndërkombëtare, qeveria shqiptare synon të forcojë koordinimin ndërinstytucional në luftën kundër krimit të organizuar, terrorizimit, trafikimit në të gjitha format e tij dhe parandalimin e goditjen e pastrimit të parave.

Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nuk duhet parë dhe kuptuar thjesht si përgjegjësi vetëm e një institucioni, bashkëpunimi midis të gjithë aktorëve është element shumë i domosdoshëm i efikasitetit të kësaj lufte. Suksesi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar varet nga bashkëpunimi i ndërsjellë midis institucioneve dhe agjencive ligjzbatuese. Situata globale e krimit të organizuar dhe terrorizmit bëjnë

të domosdoshme forcimin e bashkëpunimeve të gjera edhe me partnerët ndërkombëtarë, të vendeve të rajonit, BE-së apo SHBA-ve.

Monitorimet ndërkombëtare²⁷, lidhur me përpjekjet që duhet të bëjë Shqipëria në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe rolin e agjencive ligjzbatuese në këtë fushë, përmendin midis të tjerave se: *Sistemi gjyqësor vijon të mbetet i ndikuar nga politizimi, korrupsioni dhe bashkëpunimi i dobët ndërinstytucional. Hetimet proaktive, vlerësimet sistematike të riskut dhe bashkëpunimi ndërinstytucional duhet të forcoben më tepër... Bashkëpunimi ndërinstytucional i dobët ka ndikuar në hetimet proaktive të zhvilluara dhe në ushtrimin e ndjekjes penale të korrupsionit... Bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë gjatë hetimit të çështjeve komplekse mbetet i dobët. .. Megjithatë, edhe bashkëpunimi ndërkombëtar ka nevojë për përmirësime të mëtejshme ... Lidhur me bashkëpunimin gjyqësor në çështjet penale, duhet të përdoren më tepër instrumentët ekzistues, veçanërisht përdorimi i njëjësive të përbashkëta hetimore sipas nenit 20 të Protokollit të dytë Shtesë të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale.*

Problematikat e paraqitura nga ministrinë e linjës që kanë në kompetencë agjencitë ligjzbatuese që ushtrojnë funksione të policisë gjyqësore, evidentojnë edhe më dukshëm nevojën e rritjes së bashkëpunimit ndërinstytucional, si një premisë bazë për suksesin e veprimtarisë së organit të prokurorisë lidhur me hetimin dhe goditjen e kriminalitetit.

Nga analiza e problematikave të paraqitura nga ministrinë përkatëse²⁸ ka rezultuar se:

i) Shumë procedime për veprat penale kundër mjedisit janë mbyllur nga prokuroritë, duke i konsideruar shkeljet si kundërvajtje administrative. Për këtë, Ministria e Mjedisit kërkon një bashkëpunim më të mirë midis prokurorive dhe degët rajonale të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve për identifikimin dhe hetimin e veprave penale mjedisore; Nga ana tjetër ajo vlerëson se prokuroria duhet të parashikojë si një ndër prioritetet e punës së saj veprat penale në fushën e mjedisit, si dhe të krijojë njësi të posaçme në organikën e saj me prokurorë të kualifikuar dhe

²⁷ Progres Raporti 2016 për Shqipërinë, Bruksel 09.11.2016

²⁸ Ministria e Mjedisit me shkresën nr. 1439/1 datë 7.3.2017; Ministria e Mbrojtjes me shkresën nr.1586/1 datë 10.03.2017; Ministria e Brendshme me shkresën nr.1489/3 datë 31.3.2017. Ministria e Financave nuk ka përcjellë kontribut

²⁶ Ky nocion është vendosur sipas konceptit të ri penal të vendosur në Kodin Penal dhe Procedurës penale të miratuar në Kuvend në seancën e datës 30.03.2017.



profilizuar, për këtë kategori veprash penale; Ngritjen e sektorëve të policisë gjyqësore pranë Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, të cilët duhet të jenë inxhinierë pyjesh ose juristë; si dhe të kenë varësi dyfishe nga ISHMP-ja dhe prokuroritë e rretheve; Gjykon të nevojshëm vazhdimin e trajnimit të prokurorëve lidhur me krimet mjedisore brenda dhe jashtë vendit; si dhe rekomandon të kërkohet asistencë nga “ENPE”-Rrjeti Evropian i prokurorëve Mjedisorë;

ii) Ministria e Mbrojtjes vlerëson se: bashkëpunimi me organin e prokurorisë duhet dhe do të jetë i fokusuar në vazhdimin e mëtejshëm të bashkëpunimit midis prokurorisë dhe Policisë ushtarake; kryesisht në kuadrin e zhvillimit të hetimeve proaktive, përdorimin sa më efikas të metodave speciale të hetimit, dhe kryerjen e hetimeve të gjithanshme në ushtrimin e ndjekjes penale;

iii) Ministria e Punëve të Brendshme vlerëson se: Është vërejtur një bashkëpunim jo në nivelin e duhur për sa i përket rasteve të hetimit të korrupsionit me profil të lartë, ka pasur hezitim për hetime proaktive, për përdorimin e metodave speciale të hetimit apo/dhe aplikimit të veprimeve simuluese; shumë materiale verifikuese dhe procedime pasurore vazhdojnë të jenë në zyrat e prokurorisë, duke shkaktuar zvarritje të papërligjura në procesin hetimor, fakt ky që dobëson luftën në drejtëm të identifikimit të pasurive produkt i veprave penale; prokuroria nuk përfshin policinë gjyqësore në hetimet e veprave penale, edhe për veprat penale që janë referuar pikërisht nga policia gjyqësore; Mungon informacioni nga prokuroria për mënyrën e përfundimit të këtyre çështjeve (rastet më tipike shfaqen për veprat penale që referojnë strukturat e Policisë Kufitare dhe Migracionit); Hetimet penale dhe ato pasurore për çështjet penale të korrupsionit, krimin të organizuar dhe trafikëve janë të limituara në episode të veçanta pikënisje, nuk shtrihen në kohë, për të dokumentuar dhe identifikuar veprimtarinë kriminale, personat e lidhur dhe asetet, nuk kryhen të gjitha veprimet e mundshme hetimore; E njëjta situatë vihet re për hetimet e krimeve financiare kryesisht pastrimin e parave. Prokuroria nuk fillon ose pushon hetimet me arsyetimin e se mungon vepra penale origjinuese, duke treguar se ka nevojë për përmirësim të njohjes së kësaj vepre penale dhe praktikave të hetimit të saj. Edhe në këtë rast nuk

kryhen të gjitha veprimet e mundshme hetimore, është inekzistent përdorimi i metodave speciale, nuk kryhen kontrole banesash/automjetesh; si dhe nuk angazhohet struktura të tjera si: organet tatimore apo doganore;

Për të përmirësuar këtë situatë Ministria e Punëve të Brendshme kërkon që prokurori të jetë më aktiv dhe i pranishëm gjatë fazës së hetimeve paraprake dhe të mos mjaftohet vetëm me urdhrat e delegimit, kryesisht për procedime komplekse e të vështira dhe për ato ngjarje që kanë impakt dhe ndjeshmëri publike; është e nevojshme një bashkëpunim dhe kontroll më i ngushtë nga prokurori mbi oficerët e policisë gjyqësore, këta të fundit duhet të jenë të përgjegjshëm për rëndësinë që ata kanë në identifikimin dhe dokumentimin e veprave penale; Forcimin e bashkëpunimit midis prokurorisë dhe policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, për shkëmbimin e informacionit dhe përdorimin efektiv të metodave speciale të hetimit, njoftimin e vendimeve të përfundimit të hetimit për institucionet që impaktohen apo kanë lidhje me këto raste; Analiza periodike dhe adresim i përgjegjësive konkrete për mospërmblidhjen apo shkeljet e detyrës nga oficerët e policisë gjyqësore; rritjen e numrit të hetimeve, veçanërisht hetimeve proaktive për rastet e korrupsionit në sistemin e drejtësisë dhe nivelet e mesme dhe të larta të administratës shtetërore; ashpërsimin e qëndrimit ndaj kultivuesve të kanabis edhe në kuadër të plan veprimit kundër kultivimit dhe trafikimit të cannabis; Rritjen e bashkëpunimit ndërkombëtar për sfidat e përbashkëta, si lufta kundër veprave penale të rënda terroriste apo kundër krimin ndërkufitar dhe atyre me forma të posaçme bashkëpunimi për personat që i fshihen drejtësisë; konsolidimin e kapaciteteve hetimore të prokurorisë dhe krijimin e seksioneve të veçanta për krimin ekonomik apo pastrimin e parave; bashkëpunimin me partnerët rajonale dhe ndërkombëtare për parandalimin e krimeve kompjuterike, të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për financimin e terrorizmit; bashkëpunimi midis policisë dhe prokurorisë të jetë i shpejtë, për të shkurtuar kohën e paraburgimit për rastet e të miturve; Kur nevojitet kryerja e veprimeve procedurale ndaj prindërve apo kujdestarëve të të miturve, dhe nuk ka mundësi për gjetjen e një vendi të sigurt për akomodimin e tyre, veprimet të



kryhen në vendbanimin apo vendqëndrimin e tyre, sugjerim edhe i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi; ashpërsimin e dënimeve ndaj personave të akuzuar për vepra penale të krimit të organizuar, krimeve të rënda kundër jetës, korrupsionit, krimit financiar, armëmbajtjes pa lejë, veprave penale që çenojnë mjedisin, etj. Aplikim të gjykimit të drejtpërdrejtë dhe procedurave të reja të gjykimit të posaçme për ekonomi kohe dhe mjetesh, si dhe shkurtim kohe paraburgimi.

Bazuar në konstatimet e sipërcituara, me qëllim përmirësimit e bashkëpunimit ndërinstitucional, **Këshilli i Ministrave i rekomandon Prokurorit të Përgjithshëm:**

i) Rritjen e bashkëpunimit me Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve, për identifikimin dhe hetimin e veprave penale mjedisore, duke parë mundësinë e krijimit të njëjësive me staf të trajnuar për krimet mjedisore;

ii) Rritjen e bashkëpunimit me policinë ushtarake, kryesisht në kuadrin e zhvillimit të hetimeve proaktive, dhe metodave speciale të hetimit, me qëllim kryerjen e hetimeve të gjithanshme në ushtrimin e ndjekjes penale për veprat penale ushtarake;

iii) Rritjen e bashkëpunimit me Policinë e Shtetit dhe agjencitë e tjera ligjzbatuese, për kryerjen e hetimeve komplekse, shkëmbimin e informacionit në kohë dhe duke ruajtur sekretin hetimor, kryerjen e metodave speciale të hetimit, kryerjen e kontroleve, identifikimin e personave/grupeve kriminale, aseteve kriminale dhe personat e lidhur me to, sidomos sa i përket veprave penale në fushën e korrupsionit, krimit të organizuar, pastrimit të parave, dhe veprave të tjera që çenojnë rendin dhe sigurinë në vend;

iv) Rritjen e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar sidomos për veprat penale të terrorizmit, krimit të organizuar, krimit ndërkufitar, parandalimin e krimeve kompjuterike, të përdorura për pastrimin e të ardhurave nga aktivitete kriminale në përgjithësi, si dhe ato për financimin e terrorizmit si dhe bashkëpunimet e posaçme për personat që i fshihen drejtësisë;

v) Shtimin e rasteve të përdorimit të njëjësive të përbashkëta hetimore sipas nenit 20 të Protokollit të dytë Shtesë të Konventës për Ndihmën e Ndërsjellë Juridike në Çështjet Penale;

vi) Rritjen e bashkëpunimit dhe kontrollit nga prokurori mbi oficerët e policisë gjyqësore, me

qëllim dokumentimin e veprave penale, rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së hetimeve të kryera prej tyre; Për këtë kërkohet që prokurori të jetë më aktiv dhe i pranishëm gjatë kryerjes së veprimeve hetimore duke udhëhequr, mbikëqyrur dhe bashkëpunuar me oficerët e policisë gjyqësore, kryerjen e analizave periodike dhe adresimin e përgjegjësive konkrete për mospërmbyshjen apo shkeljet e detyrës nga oficerët e policisë gjyqësore;

vii) Të rriten rastet e përfshirjes në kryerjen e veprimeve hetimore të oficerëve të shërbimeve të tjera të policive gjyqësore²⁹, për rastet e referuara në prokurori prej tyre, duke u bërë të njohur atyre edhe vendimet përfundimtare për ato raste;

viii) Forcim të bashkëpunimit ndërinstitucional, për shkëmbimin e të dhënave ndërmjet institucioneve, sidomos për veprat penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, në funksion të konsolidimit të një sistemi solid të dhënash statistikore, që pasqyron rrjedhën procedurale të procedimeve në çdo fazë.

UDHËZIM

Nr. 2 datë 14.4.2017

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 1, DATË 16.3.2017 “PËR MËNYRËN DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PLANEVE TË PËRGJITHSHME VENDORE”

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neneve 5 dhe 8 të ligjit nr. 107/2014, datë 30.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, nenit 14 të Ligjit nr. 9244, datë 17.6.2004, “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar, nenit 11/1 të ligjit nr. 8752, datë 26.3.2001 “Për krijimin dhe funksionimin e strukturave të administrimit dhe mbrojtjes së tokës”, i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 671, datë 29.7.2015 “Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 410, datë 27.6.2012 “Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave të ndryshimit të kategorive të resurseve të tokës”,

²⁹ Oficerët e policisë gjyqësore së Ministrisë së Financave (hetimit tatimor, doganave), Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Mjedisit, Ministrisë së Punëve të Brendshme.



UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 1, datë 16.3.2017, “Për mënyrën dhe procedurat e zbatimit të planeve të përgjithshme vendore” mbas paragrafit “DH”, bëhen këto shtesa :

1. Shtohet paragrafi “ E” me përmbajtje si më poshtë:

“E. Fillimi i zbatimit të Planeve të Përgjithshme Vendore

16. Plani i Përgjithshëm Vendor hyn në fuqi dhe fillon të zbatohet nga data e botimit në Regjistrin e Integruar të Planifikimit të vendimit të KKT-së që e miraton atë, së bashku me dokumentacionin shoqërues, sipas nenit 56, paragrafi 2, i ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar.

17. Deri në momentin e hyrjes në fuqi të Planit të Përgjithshëm Vendor, sipas pikës 16 më sipër, gjejnë zbatim aktet ligjore që rregullojnë zhvillimin e territorit në mungesë të planeve vendore, përfshirë vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 283, datë 1.4.2015, “Për përcaktimin e tipave, rregullave, kritereve dhe procedurave për ndërtimin e objekteve për prodhimin, ruajtjen dhe përpunimin e produkteve bujqësore dhe blegtorale, në tokë bujqësore”, të ndryshuar dhe vendimi nr. 1, datë 30.7.2015, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave që do të ndiqen nga autoritetet e zhvillimit të territorit për shqyrtimin e kërkesave për leje ndërtimi, deri në miratimin e planeve të përgjithshme vendore””.

Ngarkohen bashkitë dhe Agjencia e Zhvillimit të Territorit me zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I ZHVILLIMIT URBAN
Eglantina Gjermeni

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”

Çmimi 112 lekë